AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

ISSUE **102** / December 2021

# The Advantage

THE **OFFICIAL MAGAZINE** OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA



## AMCHAM DISCUSSES FISCALIZATION WITH TAX OFFICIALS

**AMCHAM CELEBRATES THANKSGIVING WITH ITS COMMUNITY**

**COMMITTEES IN ACTION** PLANS FOR 2022 CENTER ON INVESTMENT AGENDA

# AMCHAM BOARD



**PRESIDENT**
Enio JAÇO
*CBS Creative Business Solutions*



**VICE-PRESIDENT**
Edlira MUKA
*Balfin Group*



**SECRETARY**
Reshard KËLLIÇI
*The Harry T. Fultz Institute*



**TREASURER**
Juela ISAJ
*DDB Albania*

## BOARD MEMBERS



Shkumbin MUÇOLLI
*Burger King Albania*



Ilir RUDI
*Abi Bank*



Bledar BETA
*Philip Morris Albania*









**PUBLISHER:**
The American Chamber of Commerce in Albania

**EDITOR IN CHIEF:**
Brikena Kamenica

**DESIGN & LAYOUT:**
Eduard Bujari



The content of this publication cannot be reproduced in full or part without the prior written permission of the publisher.

**© COPYRIGHT JULY, 2021**



Rruga "Ibrahim Rrugova", Sky Tower, Suita 11-3 Tirana, Albania

**PHONE:**
+355 4 225 9779

**E-MAIL:**
info@amcham.com.al

**WEB:**
www.amcham.com.al


# CONTENTS / PËRMBAJTJA

**NR. 102 / DHJETOR 2021**
**ISSUE 102 / DECEMBER 2021**

The Advantage




6
AmCham discusses fiscalization with tax officials
AmCham flet për fiskalizimin me tatimorët

14
AMCHAM CELEBRATES THANKSGIVING WITH ITS COMMUNITY
AMCHAM FESTON DITËN E FALENDERIMEVE ME KOMUNITETIN E SAJ

18
COMMITTEES IN ACTION
Plans for 2022 center on Investment Agenda
KOMITETET NË VEPRIM,
Axhenda e Investimeve në qëndër të planeve për 2022




12
21ST ANNUAL AMCHAM ALBANIA GENERAL ASSEMBLY MEETING HELD
ORGANIZOHET EDICIONI I 21-TË I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME NË AMCHAM




10
ABI SHOWS HOW THE BUSINESS CLIMATE HAS CHANGED
ABI "TREGON" SI KA NDRYSHUAR KLIMA E BIZNESIT



24
BUSINESSES CAN NOW USE AEO STATUS ACROSS THE REGION
STATUSI OEA, TANI BIZNESET MUND TA PËRDORIN NË TË GJITHË RAJONIN



22
U.S.-Albania trade volume sees significant growth
Rriten ndjeshëm raportet tregtare me Amerikën

26
Member News
Lajme Anëtarësh

32
Policies can promote foreign investments
Politikat që nxisin Investimet e Huaja

36
THE PERSPECTIVE OF TOURISM, THE POTENTIAL THAT COMES FROM THE AMERICAN MARKET
PERSPEKTIVA E TURIZMIT, POTENCIALI QË VJEN NGA TREGU AMERIKAN

40
EXPROPRIATION, JUST COMPENSATION AND MARKET VALUE
SHPRONËSIMI, SHPËRBLIMI I DREJTË DHE VLERA E TREGUT

## PREMIUM CATEGORY

- BALFIN – Balkan Finance Investment Group
- Grant Thornton – An instinct for growth
- Philip Morris International
- TCN
- TITAN – Antea Cement Sh. A.
- vodafone
- WesternUnion WU

## PATRON MEMBERS

- Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Coca-Cola – Taste the feeling – CCBS
- DHL
- CCS – Computer & Copier Systems
- Kalo & Associates – Attorneys at Law
- Mercedes-Benz – Kastrati Group
- Korça Beer – edhe sot më e mira...
- Boga & Associates – Legal · Tax · Accounting
- Deloitte.
- 3N1
- Marketing & Distribution
- GSA Group
- Sigma Interalbanian – Vienna Insurance Group
- ZICO
- SIGAL UNIQA Group Austria
- Miell Tirana
- Jordil
- kesh – Albanian Power Corporation
- Kika Construction
- fufarma – since 1946
- AK Invest – Institucion Financiar
- Hotel Colosseo – Shkoder - Tirane
- Alumil – Building excellence every day
- AVON
- Egnatia Group
- abkons – Local Knowledge, Global Standards
- Krujacem – Fushë Krujë Cement Factory
- Bankers Petroleum Albania Ltd.
- InfoSoft Systems – ... stronger together ...
- Intersig – Vienna Insurance Group
- D20
- Korsel
- AlbGarden – www.albgarden.com
- EY – Building a better working world
- eida
- ProCredit Bank Albania
- THG – Turgut Holding Group
- British American Tobacco Adria
- Alpha Bank
- dimapak – make it easy
- EHW GmbH
- Teuta
- Statkraft
- Berdica cement
- Tona Korçë – Simbol i Cilësisë
- rejsi farma
- Turgut Özal Education Company – Tirana
- Tendence 3A
- Baker Hughes – a GE company
- S2 Global – An OSI Systems Company
- AlbStar
- qed – one vision.
- abi – American Bank of Investments
- gener2
- Mylan
- Aluflor – Construction Group
- CBS – Creative Business Solutions
- Guardian Glass – See what's possible
- Delia Group Construction
- Primall
- Hilton Garden Inn Tirana
- Credins bank – Ne flasim gjuhën tuaj!
- Xheko Imperial – Luxury Boutique Hotel
- Salillari L.t.d
- Holly & Endi Auditing
- ets – energy & telecomunication systems
- LUFRA
- DEKON
- VEGA Construction Group

# AmCham discusses fiscalization with tax officials

## Available soon: A guide that standardizes the process after consultations will all stakeholders.



### Directorate to address issues that its member businesses encounter in their day-to-day activities and that affect the well-being of companies.



AmCham Tax and Customs Committee experts met with Director Ceno Klosi and senior representatives of the General Tax Directorate to discuss technical issues related to the implementation of the fiscalization process and other legal issues arising from the implementation of tax legislation.

The meeting addressed issues such as access to the central billing platform; fiscalization of imports; duplication of sales invoices; issuance of corrective invoices for previously issued invoices; review and adjustment of VAT books on the central invoices platform; the need for a manual on the types of processes, invoices, payments, errors, etc .; as well as the need for legal changes in the bylaws on fiscalization in order to clarify the problems.

The American Chamber strongly requested the extension of the transitional period that allows the manual declaration in e-filing of the book of sales and purchases as well as the extension of the deadline for the implementation of penalties under the law on tax procedures until the end of 2022.

Directorate to address issues that its member businesses encounter in their day-to-day activities and that affect the well-being of companies.

At the start of the meeting, AmCham Executive Director Neritan Mullaj introduced the AmCham experts and thanked the tax director for the readiness to advance discussions on the issues AmCham highlights for solution by the tax administration. Alketa Uruçi, head of AmCham's Tax and Customs Committee, listed a number of issues that the Chamber's member businesses have raised concerns on and asked for solutions.

Director Klosi expressed readiness to address all issues at the expert level, adding that fiscalization is an ongoing process involving many actors, including companies that produce software and enable the fiscalization of invoices. To avoid problems and respond to all interpretations of the process, Director Klosi said that the General Tax Directorate is working on drafting a procedural guideline to standardize

# AmCham flet për fiskalizimin me tatimorët



## Se shpejti një udhëzues që standartizon proçesin e konsultuar me të gjitha palët e përfshira

### Takimi është pjesë e diskutimit të vazhdueshëm që Dhoma Amerikane ka me Drejtorinë e Tatimeve për të trajtuar çështje që biznesi i saj anëtar has në aktivitetin e përditshëm dhe ndikon në mbarëvajtjen e tij.

Ekspertët e Komitetit të Taksave dhe Doganave në Dhomën Amerikane janë takuar me Drejtorin Ceno Klosi dhe me përfaqësues të lartë të DPT për të diskutuar mbi çështje teknike të zbatimit të proçesit të fiskalizimit dhe çështje të tjera ligjore gjatë zbatimit të legjislacionit tatimor.

Gjatë takimit u trajtuan çështje të tilla si aksesi në platformën qëndrore të faturave; fiskalizimi i importeve; dublikimi i faturave të shitjes; lëshimi i faturave korrigjuese për faturat e lëshuara më parë; rishikimi dhe rregullimi i librave të TVSH-se në platformën qëndrore të faturave; nevoja për një manual mbi llojet e proceseve, faturave, pagesave, gabimeve etj; si dhe nevoja për ndryshime ligjore në aktet nënligjore mbi fiskalizimin me qëllim sqarimin e problematikave.

Dhoma Amerikane kërkoi me forcë shtyrjen e periudhës tranzitore që lejon deklarimin manual në e-filing të librit të shitjeve dhe blerjeve si dhe shtyrjen e afatit të zbatimit të penaliteteve sipas ligjit për procedurat tatimore deri në fund të vitit 2022.

Takimi është pjesë e diskutimit të vazhdueshëm që Dhoma Amerikane ka me Drejtorinë e Tatimeve për të trajtuar çështje që biznesi i saj anëtar has në aktivitetin e përditshëm dhe ndikon në mbarëvajtjen e tij. Drejtori Ekzekutiv i AmCham Albania, Neritan Mullaj në fillim të takimit ka prezantuar ekspertët e AmCham dhe ka falenderuar Drejtorin e Tatimeve për gadishmërinë për ti çuar përpara çështjet që Dhoma Amerikane shtron për zgjidhje me administratën tatimore. Alketa Uruçi, Kryetarja e Komitetit të Taksave dhe Doganave, ka listuar një sërë çështjesh që biznesi i Dhomës ka shtruar për zgjidhje.

Drejtori Ceno Klosi lidhur me




> **The GTD experts listed several issues which were among the concerns of AmCham members** and which have been put on the path of resolution, among which are changes in the registration of the operator, making it possible for the system to accept a more extended Excel version than the one allowed by the system so far as well as the correction of invoices aligned with the old books used before fiscalization, starting from the serial number of invoices declared by both parties.

all activities related to fiscalization so that in no case the consequences of malfunction fall on the taxpayer, providing unified solutions to the problems displayed. The guidelines that will be created will be consulted with all stakeholders involved in the progress of the fiscalization.

Director Klosi said there is no turning back in terms of the fiscalization process but officials would work intensively to improve it so that the taxpayer is not exposed to any kind of risk.

Tax Committee members noted that the upcoming guidelines will help businesses and fiscal experts who work with the self-care system on a daily basis and hope that the technical problems of the system will be resolved as soon as possible. However, they stressed the need for a possible postponement of set deadlines in order to avoid penalties. But the General Tax Directorate maintained that it would not be considered as a solution.

### WHAT'S NOT WORKING WITH THE DECLARATION OF INVOICES THROUGH THE SELF-CARE PORTAL

During the meeting, the experts discussed in detail the problems encountered during the use of the self-care system.

A technology expert at the General Tax Directorate provided information on how the portal was created as a way to make it easier for taxpayers to use it, but cannot be used as an internal accounting system, because it overloads the portal and leads to delays. Meanwhile, AmCham experts specified that there are many problems that have been noticed with the system in terms of reporting and not only in terms of delays. They cited invoice duplication cases or special order invoices that are then ultimately valued at the summary invoice number. The position of the experts in the case of invoice reporting is that if an invoice is reported, it means that there are no problems, while the reporting of books will be done according to the tax legislation.

The GTD experts listed several issues which were among the concerns of AmCham members and which have been put on the path of resolution, among which are changes in the registration of the operator, making it possible for the system to accept a more extended Excel version than the one allowed by the system so far as well as the correction of invoices aligned with the old books used before fiscalization, starting from the serial number of invoices declared by both parties.

GTD experts also discussed the problem related to the 10-digit price format after the comma which needs to be solved. A change that is coming shortly involves the finalization of the transfer of sales and purchase books.

In the list of issues for discussion, AmCham experts also spoke about using e-Albania to get to the central tax system for the purpose of maintaining confidential data. Another topic touched by AmCham representatives -- and which is on the agenda of the Tax and Customs Committee -- is the application for tax agreements. Committee Chairwoman Alketa Uruçi proposed the drafting of a complete list of documentation that a subject must submit to complete the application.



> **Ekspertët e DPT-së kanë listuar disa çështje të cilat ishin mes shqetësimeve të anëtarëve të Dhomës** dhe janë vënë në rrugën e zgjidhjes, mes të cilave ndryshimet në regjistrimin e operatorit, bërja e mundur e pranimit nga sistemi të një varianti Excel më të zgjeruar sesa ai i lejuar nga sistemi deri tani, korrigjimi i faturave njehësuar me blloget e vjetra të përdorura deri para fiskalizimit duke u nisur nga numri serial i faturave të deklaruara nga të dyja palët.

të gjitha problematikat e trajtuara në nivel ekspertësh, ka shprehur gadishmërinë për t'i trajtuar dhe ka këmbëngulur se fiskalizimi është një proçes në përmirësim e sipër ku janë përfshirë shumë aktorë ndër këta edhe kompanitë të cilët prodhojnë software-t dhe mundësojnë fiskalizimin e faturave. Për të shmangur problematikat dhe dhënë përgjigje të gjitha interpretimeve mbi proçesin, Drejtori i Përgjithshëm informoi se DPT po punon për hartimin e një udhëzuesi proçedural që të standartizojë të gjitha veprimtaritë që lidhen me fiskalizimin në mënyrë që në asnjë rast pasojat e mosfunksionimit të mos bien mbi taksapaguesin dhe të këtë zgjidhje të unifikuara për problemet e shfaqura. Kjo rregullore që do të krijohet, do të konsultohet me të gjithë aktorët e përfshirë në mbarëvajtjen e proçesit të fiskalizimit. Për Drejtorin Ceno, nuk ka kthim prapa për sa i takon proçesit të fiskalizimit por do të punohet intensivisht për përmirësimin e tij me qëllim që taksapaguesi të mos ekspozohet ndaj çdo lloj rrisku.

Anëtarët e Komitetit të Taksave u shprehen se ky udhëzues do të vijë në ndihmë të biznesit dhe ekspertëve fiskalë të cilët punojnë çdo ditë me këtë sistem dhe kanë shpresë që problematikat teknike të sistemit të zgjidhen sa më shpejt të jetë e mundur. Gjithësesi ata vunë theksin tek kërkesa për një spostim të mundshëm të afateve që duhen respektuar për t'ju shmangur penaliteteve por qëndrimi i Drejtorisë ishte se kjo nuk mund të konsiderohet një zgjidhje.

### PORTALI SELF-CARE, ÇFARË NUK PO FUNKSIONON ME DEKLARIMIN E FATURAVE

Gjatë takimit ekspertët diskutuan në detaje mbi problematikat që janë hasur gjatë përdorimit të sistemit (portalit) self-care.

Eksperti i teknologjisë pranë DPT informoi gjatë takimit se ky portal është krijuar me qëllim që të lehtësojë tatimpaguesit dhe nuk mund të përdoret si sistem kontabiliteti i brendshëm, sepse mbipopullon portalin dhe shkakton problematika me vonesat. Ndërkaq ekspertët e Dhomës specifikuan se janë të shumta problematikat që janë vënë re me sistemin në pikëpamjen e raportimit dhe jo vetëm për sa i takon vonesave. Ato cituan rastet e dublikimeve të faturave ose rastet e faturave porosi që në fund marrin vlerën e faturës përmbledhëse. Qëndrimi i ekspertit për rastin e raportimit të faturave është se nëse një faturë raportohet do të thotë që nuk ka probleme, ndërkohë që në lidhje me raportimin e librave do të veprohet sipas ligjit për taksapaguesit.

Ekspertët e DPT-së kanë listuar disa çështje të cilat ishin mes shqetësimeve të anëtarëve të Dhomës dhe janë vënë në rrugën e zgjidhjes, mes të cilave ndryshimet në regjistrimin e operatorit, bërja e mundur e pranimit nga sistemi të një varianti Excel më të zgjeruar sesa ai i lejuar nga sistemi deri tani, korrigjimi i faturave njehësuar me blloget e vjetra të përdorura deri para fiskalizimit duke u nisur nga numri serial i faturave të deklaruara nga të dyja palët.

Gjithashtu ekspertët e DPT-së e konsiderojnë të zgjidhur problematikën në lidhje me formatin e çmimit me 10 shifra pas presjes. Risi që pritet të implementohet brenda një afati të shkurtër është finalizimi i transferimit të librave të shitjeve dhe blerjeve.

Në listën e çështjeve për diskutim, ekspertët e Dhomës kishin edhe aksesin mes e-albanias dhe sistemit qëndror të tatimeve për arsye të ruajtjes së të dhënave konfidenciale. Një tjetër temë e prekur nga përfaqësuesit e Dhomës dhe që është në axhendën e Komitetit të Taksave dhe Doganave, është dhe aplikimi për marrëveshjet tatimore. Kryetarja Alketa Uruçi propozoi hartimin e një liste të plotë dokumentacioni që një subjekt duhet të paraqesë për të plotësuar këtë aplikim.

## AmCham members' perception of key crisis indicators

# ABI SHOWS HOW THE BUSINESS CLIMATE HAS CHANGED



**THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA HAS PUBLISHED ITS 2020 ANNUAL BUSINESS INDEX, WHICH RECORDED A DECLINE OF 0.5 PERCENT OF BUSINESS CONFIDENCE IN ALBANIA, REDUCING THE INDEX FROM 38.1 PERCENT IN 2019 TO 37.6 PERCENT IN 2021.**

The Business Index is an expression of the perception that AmCham members have about the business climate, expressing their opinions through the evaluation they give several indicators.
Seventy-one percent of the AmCham membership participated in the survey, marking the highest participation in the nine years the index has been published, reflecting the importance that members give to the business climate and the implementation of reforms in support of its improvement.
The index measures important elements that affect the business climate, including government policies, taxation levels, corruption, informality, law implementation and elements related to the performance of Albanian businesses and the economy.

### WHAT AMCHAM MEMBERS ARE SAYING THROUGH THE BUSINESS INDEX

More than 71 percent of AmCham members who completed the survey rated the business climate in Albania as unfavorable, only 9 percent rated it as positive, and 20 percent rated it as neutral.
According to the survey, the performance of the Albanian economy has declined by 5.64 points, and 80 percent of respondents stated that the performance of the economy declined in 2020.
The Goods and Services indicator also saw a negative perception, with a decline of 7.74 points while the Demand for Export Goods and Services indicator saw a decrease of 6.67 points.
AmCham members have not been shy about complaining about employment issues, giving that indicator a result 4 points lower than a year ago. Investments was another indicator evaluated negatively by members, with a decline of 3.9 points.
The level of taxation was also a concern, assessed as non-competitive with the rest of the region. Nearly 60 percent of respondents assess the current level of taxation as unfavorable.
But it seems that the Albanian economy has also seen a few business climate developments that were seen in a positive light by the AmCham community. Members gave a positive grade to the Monopolies and Unfair Competition indicator, increasing it by 6.02 points, while the level of Corruption had a more positive perception, increasing by 3.09 points.
In the business climate-sensitive indicators, the Domestic Political Climate indicator saw the most positive assessment, rising by 7.69 percent. The indicator measuring government bureaucracy also marked a slight improvement of 1.7 percent. The law and rules enforcement indicator also saw a slight increase.

### PRESIDENT JAÇO

Enio Jaço: Albania still faces great challenges to overcome business climate issues. Cooperation with the newly-established government and parliament is critical to turn to a new page in how business is done in Albania.
The 2020-2021 Business Index results provide a real assessment that shows Albania still faces great challenges in overcoming business climate issues.
The fact that we saw an increase in participation in the survey, with 71 percent of members participating in the Index, the highest since its inception, shows the importance that businesses give to the environment in which they operate and the rules of the game. But the 0.5 point decrease from a year ago and the drop to the lowest level since the start of the index nine years ago proves the weight of the corrosive phenomena that continue to hold the country hostage as it tries to move faster toward progress.
The dynamic of events and Albania's goal to fulfill its European perspective leave no time for reflection. They show us the importance of joint action. To restore business trust, there must first be constructive dialogue and cooperation based on a high degree of responsibility. AmCham has the expectations of dialogue and finding mechanisms for cooperation with the newly-established government and parliament to turn to a new page in how business is done in Albania.



## Perceptimi i anëtarëve të AmCham për indikatorët themelorë të krizës

# ABI "TREGON" SI KA NDRYSHUAR KLIMA E BIZNESIT

**Dhoma Amerikane e Tregtisë ka publikuar Indeksin Vjetor për vitin 2020, ku regjistrohet përsëri një rënie me 0.5 për qind e besimit të biznesit në Shqipëri duke e zbritur Indeksin nga 38.1 per qind që ishte në 2019 në 37.6 për qind në 2021.**




Indeksi i Biznesit është shprehje e perceptimit që anëtarët e Dhomës Amerikane kanë për klimën e biznesit, duke e materializuar mendimin e tyre nëpërmjet vlerësimit që i japin cdo indikatori.
Në këtë anketim morën pjesë71 % e anëtarësisë së AmCham pjesëmarrja më e lartë në 9 vitet e publikimit të Indeksit duke reflektuar rëndësinë që anetarët i japin klimës së biznesit dhe realizimit të reformave në mbështetje të përmirësimit të saj.
Indeksi mat elementë të rëndësishme që ndikojnë klimën e biznesit, si politikat qeveritare, nivelin e taksave, korrupsionin, informalitetin, zbatimin e ligjit dhe elementë që lidhen me ecurinë e bizneseve dhe ekonomisë shqiptare.

### CFARË TREGUAN ANËTARËT E AMCHAM PËRMES INDEKSIT TË BIZNESIT

Më shumë se 71 për qind e anëtarëve të Dhomës Amerikane e vlerësojnë klimën e biznesit në Shqipëri si të pafavorshme, vetëm 9 për qind e vlerësojnë si pozitive dhe 20 për qind si neutrale.
Sipas studimit, performanca e ekonomisë shqiptare ka rënë me 5.64 pikë, dhe 80 për qind e të anketuarve deklaruan se performanca e ekonomisë ka rënë gjatë vitit 2020. Perceptim negative kishte dhe zeri "Mallra dhe Shërbimi cili kishte pësuar një rënie prej 7.74 pikë ndërkohë që "kerkesa për mallra dhe shërbime eksporti"kishte një rënie prej 6.67 pikë.
Anëtarët e AmCham nuk kanë hezituar të "ankohen"edhe për cështjet e punësimit duke I dhënë këtij indikatori një rezulta katër pikë më të dobët se një vit më parë. Investimet , ka qënë një tjetër indicator i vlerësuar negativisht nga anëtarët me një rënie prej 3.9 pikë.
Niveli i taksave përbënte shqetësim dhe vlerësohet si jo konkurrues në rajon. Afro 60 për qind e të anketuarve e vlerësojnë si të pafavorshëm nivelin aktual të taksave.
Por duket se në perfomancën e ekonomisë shqiptare dhe mes zërave të klimës së biznesit, ka patur dhe zhvillime pozitive të njohura prej komunitetit të AmCham. Anëtarët i kanë dhënë notë pozitive, treguesit të "Monopoleve dhe Konkurrencës së Pandershme" duke e rritur me 6.02 pikë ndërkohë që Niveli i Korrupsionit ka patur një perceptim më pozitiv duke u rritur me 3.09 pikë.
Në idikatorët sensitive për klimën e biznesit Klima e Brendshme Politike ka patur një vlerësim mjaft pozitiv duke u rritur me 7.69 për qind. Burokracia qeveritare ka shënuar një përmirësim të lehtë me 1.7 për qind dhe po ashtu dhe aplikimi i ligjit dhe i rregullit.

### PRESIDENTI JACO

Enio Jaço: Shqipëria ka ende sfida të mëdha për të kapërcyer me klimën e biznesit! Bashkëpunim me Qeverinë e re dhe Parlamentin e ri është kritike për një faqe të re në mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri
Rezultatet e Indeksit të Biznesit për vitin 2021 janë matës real që tregojnë se Shqipëria, ka ende sfida të mëdha për të kapërcyer me klimën e biznesit.
Rritja me 71% e anëtarëve që morën pjesë në Index, më e larta që në krijimin e saj, tregon për rëndësinë që bizneset i japin terrenit ku ata operojnë dhe rregullave të lojës. Por rënia me 0.5 pikë nga një vit më parë dhe rënia në nivelin më të ulët që në fillimin e Indexit 9 vjet më parë dëshmon peshën e fenomeneve gërryese që vijojnë të mbajnë peng vendin drejt një përparimi më të shpejtë. Dinamika e zhvillimeve por edhe perspektivës Europiane që Shqipëria synon, nuk lë më kohë për reflektim, por nxit rëndësinë e një aksioni të përbashkët.
Në kthimin e besimit tek bizneset, duhet së pari, dialog dhe bashkëpunim konstruktiv me përgjegjësi të lartë. Dhoma Amerikane ka pritshmërinë e dialogut dhe gjetjes së mekanizmave te bashkëpunimit me Qeverinë e re dhe Parlamentin e ri për të krijuar një faqe të re në mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri!

### Members elect President, Secretary and two members of the Board of Directors

# 21st annual AmCham Albania General Assembly Meeting held

The American Chamber of Commerce in Albania has held its annual General Assembly Meeting, where members elected the chamber's President, Secretary and two members of the Board of Directors. The year's largest and most important event for the chamber featured a panel of speakers that included Finance Minister Delina Ibrahimaj, U.S. Ambassador to Tirana Yuri Kim and Entela Ruçi of Bechtel -- moderated by incoming AmCham Albania Executive Director Neritan Mullaj.







In his remarks, AmCham President Enio Jaço provided a summary of the chamber's work since the previous annual assembly and thanked in particular all those who helped AmCham during the year. He also thanked outgoing Executive Director Ilir Trimi and welcomed dhe new Executive Director Mr. Mullaj.

In his address to the Assembly, President Jaço called on the government to make more of an effort to establish fair, competitive and honest practices. "We commend the government for its initiatives to reduce the informality of the gray economy through mandatory electronic billing, but we also encourage it to make more efforts to eradicate the black economy by accepting Western programs on anti-money laundering practices. These measures would increase interest among serious investors toward Albania," President Jaço said.

Focusing on American investments in Albania, Mr. Jaço welcomed Bechtel, the largest construction company in the United States, as the newest AmCham Albania member, expressing optimism that with the right climate, other American investments will also become a reality in Albania. Mr. Jaço added that the Investment Agenda has made AmCham's vision more concrete for an economy that is competitive and attractive to foreign investors.

The U.S. Embassy has also placed businesses' success as one of the three pillars of its work, and the Albanian government is building a long-term development strategy to meet that goal.

"I hope the Investment Agenda will be implemented. We look forward to working with the Government, the Ministry of Finance and Parliament to make it a reality. It's time to stop discussing the problems of the business climate and launch concrete legal interventions to improve it, offering opportunities and development for all," Mr. Jaço said.

In her remarks, U.S. Ambassador Yuri Kim also focused on the AmCham Investment Agenda. "There is still more work to be done, and we call on the Albanian government to give priority to improving the business climate, to really unlock the potential that we all know exists here. The government should take the recently published AmCham Investment Agenda seriously and look at it as a guide on how to improve the business climate," Ambassador Kim said.







Finance Minister Delina Ibrahimaj confirmed that the Albanian government is implementing reforms that will bring another approach to the business climate, aiming to make Albania an attractive country in the Western Balkans, and cooperation with the AmCham in this regard will play a major role.

## BOARD OF DIRECTORS ELECTIONS

AmCham's General Assembly Meeting serves as the venue where members elect the chamber's leaders, who will run AmCham for a two-year term. Five candidates competed for the positions of President, Secretary and two members of the Board of Directors.

At the end of the voting process, Enio Jaço of CBS Creative Business Solutions was reelected as President of AmCham Albania. Reshard Këlliçi of the Harry Fultz Institute was elected as Secretary of the Board, while Ilir Rudi of ABI Bank and Shkumbin Muçolli of Burger King Albania were elected as members of the Board of Directors.

All candidates had the opportunity to introduce themselves to AmCham members, who attended the event virtually, explaining their vision on how they will help the organization achieve its objectives.



### Anëtarët zgjedhin Presidentin, Sekretarin dhe dy anëtarë të Bordit Drejtues

# Organizohet edicioni i 21-të i Asamblesë së Përgjithshme në AmCham

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri organizoi Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë, nëpërmjet së cilës u zgjodhën Presidenti, Sekretari dhe dy anëtarë të Bordit Drejtues. Takimi më i madh dhe më i suksesshëm i vitit, pati prezencën e Ministres së Financave, znj. Delina Ibrahimaj, Ambasadores Amerikane në Tiranë, znj. Yuri Kim, Përfaqësueses së Bechtel, znj. Entela Ruçi dhe u moderua nga Drejtori i ri i AmCham Albania, z. Neritan Mullaj.

Presidenti i Dhomës bëri një përmbledhje të punës një vjeçare dhe falenderoi në mënyrë të veçantë në fjalën e tij të gjithë aktorët që kanë ndihmuar Dhomën Amerikane gjatë këtij viti. Ai falenderoi Drejtorin në ikje, z. Ilir Trimi dhe i uroi mirëseardhjen Drejtorit të ri, z. Neritan Mullaj.

Gjatë fjalës së tij në Asamble, Presidenti Jaço kërkoi nga qeveria më shumë përpjekje në krijimin e praktikave të drejta, konkurruese dhe të ndershme. "Ne përgëzojmë qeverinë për nismat në reduktimin e informalitetit të ekonomisë gri përmes faturimit elektronik të detyrueshëm, por ne e inkurajojmë atë, që të bëjë më shumë përpjekje për të ç'rrënjosur ekonominë e zezë, duke pranuar programet perëndimore mbi praktikat kundër pastrimit të parave. Këto masa do të rrisnin interesin e investitorëve seriozë drejt Shqipërisë"- u shpreh Presidenti Jaço.

Duke u ndalur tek investimet amerikane në Shqipëri, z. Jaço i uroi mirëseardhjen kompanisë amerikane Bechtel, si anëtari më i ri i Dhomës Amerikane dhe shprehu optimizëm se me klimën e duhur, të tjera investime amerikane do të bëhen realitet në Shqipëri. Z. Jaço ka përmendur gjithashtu faktin se Axhenda e Investimeve ka konkretizuar vizionin e AmCham, për një ekonomi konkurrente dhe atraktive për investimet e huaja.

Ambasada Amerikane gjithashtu e ka vendosur biznesin në një nga tre shtyllat themelore të punës dhe qeveria shqiptare është duke ngritur mbi këtë objektiv një strategji afatgjatë të zhvillimit.

"Shpresoj që Axhenda e Investimeve do të implementohet. Ne presim të bashkëpunojmë me Qeverinë, Ministrinë e Financave dhe Parlamentin për ta kthyer atë në realitet. Ka ardhur koha që të ndalojmë së diskutuari problemet e Klimës së Biznesit dhe të nisim ndërhyrjet konkrete ligjore për përmirësimin e saj, duke ofruar mundësi dhe zhvillim për të gjithë" tha z. Jaço.

Lidhur me Axhendën e Investimeve u shpreh edhe Ambasadorja Amerikane, znj. Yuri Kim, e cila tha: "Mbetet ende më shumë punë për t'u bërë dhe ne i bëjmë thirrje qeverisë shqiptare t'i japë përparësi përmirësimit të klimës së biznesit, për të zhbllokuar me të vërtetë potencialin që të gjithë e dimë se ekziston këtu. Qeveria duhet ta marrë seriozisht Axhendën e Investimeve të Dhomës Amerikane të publikuar së fundmi dhe ta shikojë atë si një udhërrëfyes se si të përmirësojë klimën e biznesit.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj, ka konfirmuar se qeveria shqiptare është duke implementuar reforma që do të sjellin një tjetër përqasje për klimën e biznesit, duke synuar të bëhet një vend atraktiv në Ballkanin Perëndimor dhe bashkëpunimi me Dhomën në këtë drejtim do të ketë një rol të madh.

## ZGJEDHJET NË BORDIN DREJTUES

Zgjedhjet në AmCham janë një moment i përzgjedhjes së liderve të rinj, të cilët do të drejtojnë Dhomën me një mandat dy vjeçar. Pesë kandidatë kanë konkurruar për pozicionet e Presidentit, Sekretarit dhe të dy anëtarëve të Bordit. Në përfundim të votimit nga anëtarët, Presidenti i AmCham Albania u zgjodh z. Enio Jaço nga CBS Creative Business Solutions, Sekretar i Bordit, z. Reshard Këlliçi nga Instituti Harry Fultz, dhe Anëtarë Bordi z. Ilir Rudi nga ABI Bank dhe z. Shkumbin Muçolli nga Burger King Albania. Të gjithë kandidatët patën mundësi të prezantohen përpara anëtarëve të AmCham, të cilët e kanë ndjekur virtualisht eventin, dhe të shpjegojnë vizionin e tyre mbi mënyrën se si do ta zhvillojnë organizatën për të arritur objektivat që ka.

# AmCham celebrates Thanksgiving with its community




AmCham would like to offer special thanks the evening's sponsors:

*Platinum sponsor:*
**Credins Bank**

*Gold Sponsor:*
**Berdica Cement**
**S2 Global**
**Kalo & Associates**
**Devi-20 Grup**

*Silver Sponsor:*
**Agrotek Alb**
**Greemed Medical Solutions**










The American Chamber of Commerce in Albania has organized its annual Thanksgiving celebration, bringing together in a networking event its community and contributors. AmCham members celebrated this typical American holiday in the same fashion as it is celebrated in the United states, with traditional food and decorations, colors and other elements that are typical for the holiday. Families had brought their children to participate in the festivities, helped by a special program tailored to kids with entertainers.

AmCham President Enio Jaco said in his remarks at the event that: "I celebrated Thanksgiving Day for the first time in America, and I was impressed by the multitude of invitations that came to me to celebrate with the families of my friends. It was there I realized that the essence of this holiday is to share with others -- not just food but also to develop gratitude for everything you have achieved in life."

This was a difficult year for many businesses, Mr. Jaco said, praising the strength and resilience shown and thanking in particular members who cooperated with the organization despite the difficulties.

AmCham Executive Director Neritan Mullaj also greeted the attendees, thanking the members and the AmCham Board for their support.

"I'm proud to lead this organization today, and please allow me to thank the AmCham Board for entrusting me with this task, and above all, for the support it gives in drafting and implementing AmCham policies," Mullaj said.

Thanksgiving's purpose as a holiday is for Americans to express their gratitude and thanks for every opportunity they have had in life. Through AmCham's efforts, it is also becoming a tradition in many Albanian families.

During this special holiday, Americans thank God for the opportunity to be with family, for the food on the table, for their health, work and life.

Beyond giving thanks, in the unusual times we live in, AmCham brings together all its members to thank them for the volunteerism, sense of solidarity and help they demonstrated during these two difficult years of the pandemic, making everyone in the community feel part of a large family.



# AmCham feston Ditën e Falenderimeve me komunitetin e saj

Dhoma Amerikane organizoi ceremoninë me rastin e Ditës së Falenderimeve duke zhvilluar network-un me komunitetin dhe bashkëpunëtorët esaj. Anëtarët e Dhomës Amerikane festuan së bashku një festë tipike amerikane ashtu sikurse festohet në Amerikë, që nga ushqimi tradicional te dekorimet me ngjyrat dhe elementët e kësaj feste. Fëmijët, ishin pjesë e ceremonisë dhe kanë ndërvepruar me animatorët dhe programin e përzgjedhur për ta.

Presidenti i Dhomës Amerikane Enio Jaco në përshëndetjen e tij për anëtarët u shpreh se 'Ditën e Falenderimeve e kam festuar për herë të parë në Amerikë dhe më ka bërë përshtypje moria e ftesave që më erdhën për të festuar me familjet e miqve te mi. Aty kuptova që thelbi i kësaj feste është të ndash me të tjerët jo vetëm ushqimin por edhe të zhvillosh mirënjohjen për cdo gjë që ke arritur në jetë"

Dhoma Amerikane falendon në mënyrë të vecantë sponsorat e kësaj mbremje:

*Platinum sponsor:*
**Credins Bank**

*Gold Sponsor:*
**Berdica Cement**
**S2 Global**
**Kalo & Associates**
**Devi-20 Grup**

*Silver Sponsor:*
**Agrotek Alb**
**Greemed Medical Solutions**

Duke folur për një vit të vështirë me të cilin u përballën bizneset, z.Jaco vlerësoi forcën dhe qëndrueshmërinë e tyre duke i falenderuar në mënyrë të vecantë anëtarët të cilët kanë bashkëpunuar me organizatën pavarsisht vështirësive.

Cermonia është përshëndetur nga Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Amerikane z.Neritan Mullaj i cili ka falenderuar anëtarët dhe Bordin e AmCham për mbështetjen.

"Si Drejtor i sapozgjedhur në detyrë, ky për mua është eventi i parë ku mund t'i takojë të gjithë antarët"- u shpreh z. Mullaj.

Dita e Falenderimeve dhe qëllimi i kësaj feste, ku populli amerikan shpreh mirënjohjen dhe falenderimet për çdo mundësi që kanë patur në jetë, po kthehet nëpërmjet angazhimit të Dhomës Amerikane në një traditë edhe për familjet shqiptare.

Nëpërmjet këtij rituali, amerikanët falenderojnë Zotin për mundësinë e të qënit me familjen, për ushqimin në tavolinë, shëndetin, punët dhe jetën.

Dhoma Amerikane përtej këtyre falenderimeve, në kohën e pazakontë që jetojmë, mbledh të gjithë anëtarët e saj, për t'i falenderuar për vullnetarizimin, ndjenjën e solidaritetit dhe të ndihmës që demonstruan në këto dy vite të vështira të pandemisë, duke na bërë të ndihemi në komunitet si në një familje të madhe.



# COMMITTEES IN ACTION

## Plans for 2022 center on Investment Agenda

AmCham's committees have met to define their work plans for 2022, with the implementation of the Investment Agenda playing a central role. Each committee has defined its area of expertise, issues covered in the Investment Agenda and how the engagement of all experts will enable AmCham to meet the goals set when the Investment Agenda was created.

All committee meetings used a portion of their time for the introduction of new AmCham Executive Director Neritan Mullaj, who spoke about his professional experience and his plans for AmCham, a good part of which also relate to the work and cooperation with committees.
The first meetings of the committees served to start work on the annual program for 2022. AmCham is also working to get the opinion of its members on any topic or issue they want to be addressed by the committees in the upcoming year.



### TAX AND CUSTOMS COMMITTEE

The 2022 Fiscal Package and the changes it brings were the focus of attention of the Tax and Customs Committee headed by Alketa Uruçi. The committee's experts paid special attention to the impact that the changes would bring to business operations, listing objections that will be the basis of discussion with the government and parliamentary committees.
The committee meeting discussed its work plan moving forward, making decisions on holding roundtables on topics such as fiscalization, double taxation agreements and needed training sessions for businesses on the latest changes to the fiscal system.
Beyond the Fiscal Package, the committee's experts discussed organizing a meeting of a group of representatives with the General Tax Directorate, where some of the issues that can be discussed are fiscalization, the Tax Administration's Central Invoice Platform (Self Care) and the problems that have recently emerged in its use. Another issue looked at by the Tax and Customs Committee was the simplification of procedures for the implementation of tax treaties (direct implementation of treaties by removing the application process with the General Tax Directorate).



# KOMITETET NË VEPRIM

## Axhenda e Investimeve në qëndër të planeve për 2022

Komitetet në AmCham janë takuar për të përcaktuar planin e tyre të punës në 2022, pjesë e të cilës do të jetë dhe implementimi i Axhendës së Investimeve. Cdo komitet ka të përcaktuar në fushën e vet të ekspertizës disa nga çështjet që mbulon Axhenda e Investimeve, dhe angazhimi i të gjithë ekspertëve do të bëjë të mundur që Dhoma Amerikane të realizojë qëllimin e krijimit të Axhendës së Investimeve.

Komitetet kanë patur një emërues të përbashkët në takimet e tyre, atë të prezantimit të Drejtorit të ri Ekzekutiv z.Neritan Mullaj i cili ka folur për curriculumin e tij profesional dhe planet me Dhomën Amerikane, një pjesë e mirë e të cilave prek dhe punën dhe bashkëpunimin me komitetet.
Takimet e para të Komiteteve kanë qënë iniciuese të programit vjetor për 2022. AmCham po punon për të marrë edhe mendimin e anëtarëve për çdo temë apo çështje që ata duan të trajtohen nga Komitetet gjatë vitit në vijim.



### KOMITETI I TAKSAVE DHE DOGANAVE

Paketa Fiskale 2022 dhe ndryshimet që ajo sjell, kanë qënë në qëndër të vëmendjes së Komitetit të Taksave dhe Doganave të drejtuar nga Alketa Uruçi. Ekspertët në Komitet i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë impaktit që sjellin ndryshimet në aktivitetin e biznesit, duke listuar objeksionet e tyre që do të jenë dhe baza e diskutimit me qeverinë dhe Komisionet Parlamentare.
Takimi i Komitetit diskutoi planin e punës në vijim, për të vendosur në tryezat e diskutimeve, tema si fiskalizimi, marrëveshjet për tatimin e dyfishtë apo format e trajnimit të bizneseve me risitë e fundit nga sistemi fiskal
***Pandemia afektoi turizmin jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë Rajonin dhe Europë, si e shikoni ju rrugëdaljen nga kjo krizë, cfarë do kërkonit nga qeveria si masa lehtësuese?***

Normalisht bizneset u paralizuan për disa muaj në 2020 në Shqipëri gjatë mbylljes së vendit dhe situata ishte e vështirë për shkak të shumë anullimeve në udhëtime për muaj me rradhë, por mendoj se Qeveria Shqiptare më pas, e menaxhoi situatën mirë në momentin që e bëri Shqipërinë të aksesueshme nga amerikanët dhe pjesën tjetër të botës pa vendosur protokolle si shtetet e tjera.

Kjo na ofroi prioritet dhe siç përmenda më lart, na lejoi të promovojmë Shqipërinë në të gjitha rrjetet ku ne marrim pjesë për të reklamuar Shqipërinë si të vetmin vend që është i lirë dhe i hapur për këdo. Kjo solli edhe rekorde të tilla turistësh në vend.

Nga qeveria Shqiptare presim, që të na ofrojë mundësi të bashkëpunojmë me të dhe ta këshillojmë për hapat që duhet të ndërmarrin me Ministrinë e Turizmit, Ministrinë e Jashtme etj, në rolin e operatorëve me eksperiencë dhe sukses në këtë fushë, për të hapur rrugët e PR dhe marketimit të Shqipërisë në përmasa më të gjera këtu në Amerikë.

Mbështetja e tyre do të sillte më shumë mundësi për të gjithë strukturat akomoduese dhe agjensitë operuese në tregun Shqiptar.

Rrugëdaljen nga kriza që ka përfshirë gjithë botën tashmë, e shoh vetëm në shfrytëzimin e kësaj situate globale për të promovuar dhe për të sjellë më shumë turistë, si vend që ofron paketat më të mira në rajon.



# EXPROPRIATION, just compensation and market value



Analysis by
**ANTON LEZHJA**,
Director of Financial Evaluation and Modeling at Deloitte Albania and Kosovo, published in the Gazeta Shqiptare daily newspaper.

Since the adoption of the Constitution of Albania as well as Law Nr. 8561, dated Dec. 22, 1999, "On expropriation and temporary use of private property for public interest," the process of expropriation for public interest has been mostly implemented in areas outside the cities and for agricultural land. Recently, the need to improve and expand the infrastructure of cities has brought the need to expropriate urban land and buildings, be they residential dwellings or commercial activity buildings. Numerous complaints by expropriated residents and owners highlighted by media coverage indicate that something is wrong with the expropriation process. Through this article, I will try to address some aspects of property valuation for expropriation purposes. Although I have to mention parts of the legal framework, the aim will not be their legal interpretation, but to provide a view of the legal framework from the point of valuation.

## 1. WHAT IS MEANT BY THE TERM "JUST COMPENSATION"?

The basis of property expropriation in the public interest is just compensation (Article 41.1 of the Constitution). But what does "just compensation" mean? Personally, I have not had the opportunity to see an interpretation of the term "just compensation" in Albanian legislation, but I am referring to the legislation of some other countries.

The Fifth Amendment of the U.S. Constitution states that "No person shall ... be deprived of life, liberty, or property, without due process of law; nor shall private property be taken for public use, without just compensation." The U.S. Supreme Court has established the following rules for interpreting the term "just compensation" in relation to expropriations by the Federal Government:

1. There is no clear rule for determining what makes compensation just in all circumstances and in all cases, nor is there a fixed rule to require payment in any particular manner.
2. Fair market value is normally accepted as the standard for just compensation.
3. Determining how much a compensation is "just" is a legal function that can't be determined by the U.S. Congress.
4. Just compensation relates to the value of the property on the date of expropriation; and if that value reflects the price to be received in a negotiated sale between the parties, it does not matter if the owner paid more or less for the property ..."

In Switzerland, the Constitution states: "In cases of expropriation, and placement of ownership restrictions that are equivalent to expropriation, just compensation will be paid." Van der Walt explains that this means that: "Article 22 (3) requires full compensation (volle Entschädigung) for expropriation, and consequently the general principle is that the compensation must place the expropriated in the same position the owner would be in the absence of expropriation. The amount of compensation consists of the market value of the expropriated property, as well as any possible loss of value resulting from a partial or substantial expropriation and compensation for damages and losses arising therefrom.

Article 13 (2) of the Constitution of the Federation of Malaysia of 1957 states that: "No law may permit the compulsory purchase or use of property without adequate compensation."

The Australian Constitution states that "The Parliament shall, subject to this Constitution, have power to make laws for the peace, order, and good government of the Commonwealth with respect to ... the acquisition of property on just terms from any State or person for any purpose in respect of which the Parliament has power to make laws."

Specialists further explain that the sub-context in the articles of compensation for the purchase of land is to ensure that the expropriated owner is neither in a worse nor a better position, due to the expropriation. Current statutes recognize the fact that the value of the sale of the land may not be sufficient to ensure that no further losses are incurred by an owner.

The 1949 Basic Law





# SHPRONËSIMI, shpërblimi i drejtë dhe vlera e tregut



Analize nga
**ANTON LEZHJA**,
Drejtor i Vlerësimit Financiar dhe Modelimit tek Deloitte Albania dhe Kosova

Qysh nga miratimi i Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe i Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në pjesën më të madhe procesi i shpronësimit për interes publik është zbatuar në zona jashtë qyteteve dhe për toka bujqësore. Kohët e fundit, nevoja për përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së qyteteve, ka sjellë edhe nevojën e shpronësimit duke përfshirë troje dhe ndërtesa, qofshin banesa apo ndërtesa për veprimtari tregtare.
Ankimet e shumta që janë vënë re në media nga qytetarët e shpronësuar kanë nxjerrë në pah se diçka nuk shkon në procesin e shpronësimit.
Me anë të këtij artikulli do të mundohem të trajtoj disa aspekte të vlerësimit të pronave për qëllimet e shpronësimit. Edhe pse më duhet të përmend pjesë të kuadrit ligjor, synimi nuk do të jetë interpretimi juridik i tyre, por kuadri ligjor i parë në këndvështrimin e vlerësimit.

## ÇFARË KUPTOHET ME TERMIN "SHPËRBLIM I DREJTË"?

Themeli mbi të cilin bazohet shpronësimi i pronave është interesi publik dhe kompensimi me një shpërblim të drejtë i tyre (neni 41.1 i Kushtetutës). Por çfarë do të thotë "shpërblim i drejtë"? Personalisht nuk kam patur rastin të shikoj një interpretim të termit "shpërblim i drejtë" në legjislacionin shqiptar, por po i referohem legjislacionit të disa vendeve të tjera.
Amendamenti i Pestë i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës shprehet se "Asnjë personi nuk do t'i privohet jeta, liria, ose prona, pa një proces të duhur ligjor: as prona private nuk mund të merret për përdorim publik pa një shpërblim të drejtë" (just compensation). Gjykata e Lartë e SHBA ka përcaktuar rregullat e mëposhtme për interpretimin e termit "shpërblim i drejtë" në lidhje me shpronësimet nga ana e Qeverisë Federale:

1. Nuk ekziston një rregull i qartë për të përcaktuar se sa një shpërblim është i drejtë në të gjitha rrethanat dhe në të gjithë rastet, as nuk ka një rregull të fiksuar që të kërkojë pagesën në çdo lloj mënyre të veçantë.
2. Vlera e drejtë e tregut normalisht pranohet si një standard i drejtë.
3. Përcaktimi se sa një shpërblim është "i drejtë" është një funksion juridik që nuk mund të parashihet nga Kongresi.
4. Shpërblimi i drejtë lidhet me vlerën e pronës në datën e marrjes; dhe nëse ajo vlerë reflekton çmimin që do të merrej në një shitje të negociuar mes palëve, nuk ka rëndësi nëse pronari pagoi më shumë apo më pak për pronën.....".

Në Zvicër, Kushtetuta shprehet se "Në rastet e shpronësimit, dhe kufizimit të pronësisë ekuivalent i shpronësimit, do të paguhet shpërblimi i drejtë". Van der Walt shpjegon se kjo do të thotë që: "Neni 22(3) kërkon shpërblimin e plotë (volle Entschädigung) për shpronësimin, dhe rrjedhimisht parimi i përgjithshëm është që shpërblimi duhet të vendosë të shpronësuarin në të njëjtin pozicion në të cilin ai do të kishte qenë në mungesë të shpronësimit. Masa e shpërblimit përbëhet nga vlera e tregut e pronës së shpronësuar, si dhe çdo humbje e mundshme



of the Federal Republic of Germany requires that the compensation paid during the expropriation "reflect a just balance between the public interest and the interest of the persons affected." (Article 14.3 "Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland").

The interpretation of the term "just" by the courts, according to Van der Walt, is as follows: In accordance with legal precedents, the term "just" is not synonymous with full compensation, but a measure that should probably be determined individually in each case where appropriate, referring to justice either for the affected persons or for the benefit of the community. "The market value of a property -- defined as the price that a willing and reasonable buyer would be willing to pay instead of losing the purchase, or that a willing and reasonable seller would be willing to accept from the sale -- constitutes one of the basic principles of defining the term "just" -- however other factors such as the value of the property to the owner himself and the consequences of other losses must also be taken into account."

A court ruling in South Africa states that the equivalent balance required by the Constitution to determine just and equal compensation, in most cases, is best achieved by first determining the market value of the property and then adding or reducing value as other important circumstances may require.

In the same vein, the Court of Appeals in Nova Scotia (Canada) considered the just compensation of a couple whose farmland was damaged as a result of the construction of a section of the TransCanada Highway that passed through their property. Prior to the expropriation of their lands for highway construction they had had a business of growing and cultivating blueberries for many years. The expropriated lands consisted of both areas currently cultivated and areas expected to be cultivated. The owners had claimed and been rewarded not only for the expected blueberry cultivation of the expropriated fields, but also for a 100 meters wide strip on both sides of the highway to protect themselves from the effects of the ice-melting salt used on the highway during the winter. In addition to these compensations, they were also given an additional compensation for the loss of value caused to their home as a result of traffic noise and to cover the costs necessary to reduce the noise inside the house.

## 2. JUST COMPENSATION AND MARKET VALUE

The entire legal and sub-legal framework pursuant to the Constitution of Albania is based on (1) the assumption that expropriation will take place at market value as an indicator of just compensation and (2) market value is determined by Decisions of the Council of Ministers (DCMs), based on value maps prepared by the Property Restitution and Compensation Agency (PRCA) with the information received from the Immovable Property Registration Office (IPRO).

Legislation in developed countries cited in the above section, as an expression of the general principles of international law, evoked by Article 2 of Law Nr. 8561, dated Dec. 22, 1999 on "Expropriation and temporary use of private property for public interest," clearly shows that a superficial equation can not be drawn between market value and just compensation since there are many other factors that must be considered to arrive at the right compensation.

Let's analyze in more detail the second factor. Does the map approved by the Council of Ministers express the value of the property market each year? The basis for determining the price of lands in Albania is DCM Nr. 658, dated Sept. 26, 2012 "On the approval of the methodology for the assessment of real estate properties in the Republic of Albania." So first we need to analyze what this government decision requires and offers.

Point 2 of the DCM states: "The methodology for the assessment of real estate property is the only official source for calculating the value of real estate property." This creates the impression that any kind of valuation in the Republic of Albania, whether for the purpose of private or state transactions should be guided by this decision. Point 2 of Article 1 of Annex 1 further reinforces this by stating that "the purpose of this methodology is to provide a fair solution for real estate appraisal for the purpose of property compensation or during real estate appraisal processes as a whole, ensuring respect for the right to property" (underlined by the author). In reality, real estate appraisal is carried out using more appraisal methods and techniques than what is determined by this government decision.

Article 3 of this methodology in points 2 and 3 states:

2.- The calculation of the value of the property is done according to the international standards of real estate valuation, defined in Annex 1/1 of this methodology, where: the value of the property (VP) = price of sales contract.

The user of this DCM expects to find international evaluation standards in Annex 1/1, but in fact finds a statistical analysis procedure for data processing that has nothing in common with the standards to which it refers.

3.- The price of sales contracts means the market price, according to the type of property and the purpose of its use. The market price is derived from the official data of the sales

> *"Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", shpjegojnë qartë se nuk mund të vihet një barazi sipërfaqësore midis vlerës së tregut dhe shpërblimit të drejtë meqenëse ka edhe shumë faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh për të arritur në shpërblimin e drejtë.*



e vlerës, që rezulton nga një shpronësim i pjesshëm apo i konsiderueshëm dhe kompensimi i dëmeve dhe humbjeve që rrjedhin prej tij.

Neni 13(2) i Kushtetutës së Federatës së Malajzisë e vitit 1957 shprehet se "Asnjë ligj nuk mund të lejojë blerjen e detyrueshme ose përdorimin e pronës pa një shpërblim të mjaftueshëm".

Kushtetuta Australiane shprehet se "Parlamenti, në zbatim të kësaj Kushtetute, ka fuqinë të përgatitë ligje për paqen, rregullin dhe mirëqeverisjen e Commonwealth në lidhje me .... blerjen e pronës në terma të drejtë nga çdo shtet, apo persona, për çdo qëllim.....".

Specialistët shpjegojnë më tej se "nënkonteksti në nenet e kompensimit për blerjen e tokës është të sigurojnë që pronari i shpronësuar të mos jetë as në pozicion më të keq, as më të mirë, për shkak të shpronësimit. Statutet aktuale njohin faktin se vlera e çmuar e shitjes së tokës mund të mos jetë i mjaftueshëm për të siguruar që një pronari nuk i janë shkaktuar edhe humbje të tjera.

Ligji Bazë për Republikën Federale Gjermane 1949 kërkon që shpërblimi që duhet të paguhet gjatë shpronësimit: "... të reflektojë një balancë të drejtë midis interesit publik dhe interesit të personave të prekur" (Neni 14.3 "Grundgesetz für die Bundes Republik Deutschland").

Interpretimi i gjykatave i termit "i drejtë", sipas Van der Walt, është si më poshtë: "Në përputhje me precedentët ligjorë, termi "i drejtë" nuk është sinonim i shpërblimit të plotë, por një masë që duhet të përcaktohet ndoshta individualisht rast pas rasti, duke iu referuar drejtësisë qoftë për personat e prekur, qoftë për interesin e komunitetit. Vlera e tregut e pronës, e përkufizuar si çmimi që një blerës i vullnetshëm dhe i arsyeshëm do të ishte i gatshëm të paguante në vend që të humbte blerjen, ose që një shitës i vullnetshëm e i arsyeshëm do të ishte i gatshëm të pranonte nga shitja, përbën një nga parimet bazë të përcaktimit të termit "i drejtë"; sidoqoftë faktorë të tjerë si vlera e pronës për vetë pronarin dhe rrjedhojat e humbjeve të tjera duhet gjithashtu të merren parasysh."

Një gjykatë në Afrikën e Jugut shprehet se balanca e barazvlefshme e kërkuar nga Kushtetuta për përcaktimin e shpërblimit të drejtë e të barabartë, në shumicën e rasteve, arrihet më së miri duke përcaktuar në fillim vlerën e tregut të pronës dhe pastaj duke i shtuar, apo duke i pakësuar vlerë, vlerës së tregut siç mund ta kërkojnë rrethana të tjera të rëndësishme.

Në të njëjtën linjë, Gjykata e Apelit në Nova Scotia (Kanada) mori në shqyrtim shpërblimin e drejtë të një çifti, toka bujqësore e të cilit ishte dëmtuar si rezultat i ndërtimit të një pjese të autostradës TransCanada që kalonte në pronën e tyre. Përpara shpronësimit të tokave të tyre për ndërtimin e autostradës ata kishin pasur një biznes të rritjes dhe kultivimit të boronicës për shumë vite. Tokat e shpronësuara përbëheshin si nga fusha aktualisht të kultivuara, ashtu edhe nga fusha që priteshin të kultivoheshin. Pronarët kishin pretenduar dhe ishin shpërblyer jo vetëm për zhvillimin e pritshëm të boronicave të fushat e shpronësuara, por edhe për një rrip 100m të gjerë në të dy krahët e autostradës për t'u mbrojtur nga efektet e kripës së përdorur kundra ngrirjes gjatë dimrit. Përveç këtyre kompensimeve atyre iu ishte dhënë edhe një shpërblim shtesë për humbjen e vlerës shkaktuar shtëpisë së tyre si shkak i zhurmave të trafikut dhe për të mbuluar kostot e nevojshme për uljen e zhurmës brenda shtëpisë.

## SHPËRBLIMI I DREJTË DHE VLERA E TREGUT

I gjithë kuadri ligjor dhe nënligjor në zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë është mbështetur në (1) supozimin se shpronësimi do të bëhet me vlerën e tregut si tregues i shpërblimit të drejtë dhe (2) vlera e tregut përcaktohet me vendime të Këshillit të Ministrave, bazuar në harta vlerash të përgatitura nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me informacionin e marrë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Legjislacionet e vendeve të zhvilluara të botës të cituara në seksionin më sipër, si shprehje e parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, të evokuara edhe nga neni 2 i Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 për "Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", shpjegojnë qartë se nuk mund të vihet një barazi sipërfaqësore midis vlerës së tregut dhe shpërblimit të drejtë meqenëse ka edhe shumë faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh për të arritur në shpërblimin e drejtë.

Le të analizojmë më në detaj faktorin e dytë, d.m.th. a shpreh harta e miratuar nga Këshilli i Ministrave çdo vit vlerën e tregut të pronave? Baza e përcaktimit të çmimit të tokave/trojeve në Shqipëri është VKM Nr. 658, datë 26.9.2012 "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë".

Kështu që fillimisht duhet analizuar çfarë kërkon dhe ofron ky vendim qeverie. Pika 2 e VKM shprehet: "Metodologjia për vlerësimin e pronave të paluajtshme është burimi i vetëm zyrtar për përllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme." Kjo të krijon përshtypjen se çdo lloj vlerësimi në Republikën e Shqipërisë, qoftë për qëllime transaksionesh private apo shtetërore duhet të udhëhiqet nga ky vendim. Pika 2 e Nenit 1 të Aneksit 1 e përforcon edhe më tej këtë duke u shprehur se "Qëllimi i kësaj metodologjie është garantimi dhe zgjidhja e drejtë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme për efekt të kompensimit të pronave ose gjatë proceseve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme në tërësi, duke siguruar respektimin e së drejtës së pronës" (nënvizimi i autorit). Në realitet vlerësimi i pasurive të paluajtshme realizohet duke përdorur më shumë metoda dhe teknika vlerësimi sesa kjo që përcakton ky vendim qeverie.

Neni 3 i kësaj metodologjie në pikat 2 dhe 3 shprehet:

2.- Përllogaritja e vlerës së pronës bëhet sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në aneksin 1/1 të kësaj metodologjie, ku: vlera e pronës (VP) = çmimi i kontratës së shitjes.

Përdoruesi i këtij VKM pret që në Aneksin 1/1 të gjejë standardet ndërkombëtare të vlerësimit, por në fakt gjen një procedurë të analizës statistikore për përpunimin e të dhënave që nuk ka asgjë të përbashkët me standardet të cilave i referohet.

3.- Çmimi i kontratave të shitjes nënkupton çmimin e tregut, sipas llojit të pasurisë dhe qëllimit të përdorimit të saj. Çmimi i tregut nxirret nga të dhënat zyrtare të kontratave të shitjes të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme.

Të gjithë jemi në dijeni të faktit që një pjesë e mirë e kontratave të shkëmbimit të pronave nuk reflektojnë shumat reale të parave që janë këmbyer, apo përdorin formën e dhurimit. A do të ishte e arsyeshme dhe jo-diskriminuese që një numër kontratash të tilla të merren si etalon për përcak-

> *"Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", shpjegojnë qartë se nuk mund të vihet një barazi sipërfaqësore midis vlerës së tregut dhe shpërblimit të drejtë meqenëse ka edhe shumë faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh për të arritur në shpërblimin e drejtë.*

contracts registered in the Immovable Property Registration Office.

We are all aware of the fact that a good portion of property exchange contracts do not reflect the actual amounts of money that have been exchanged, or use the donation method. Would it be reasonable and non-discriminatory for a number of such contracts to be taken as a benchmark for determining first the market value and then the just compensation for involuntarily depriving the rightful owner of his/her property?

Article 4 also discusses the types of assets that will be subject to this methodology, the market value of which is determined by the sale-purchase contracts. It is not at all clear what the sale-purchase contracts will be that would determine the market value of kindergartens, schools, nurseries, stadiums, dams, hydropower plants, mines, ports, bridges, etc. International valuation standards stipulate that when properties are state-owned, not for profit or which are seldom sold primarily as an integral part of businesses, they are valued based on the amortized cost of replacement.

Annex 1/1 has nothing in common with international valuation standards. It is a statistical methodology known in the valuation profession as "mass appraisal." This procedure is used in many countries for a single purpose: valuation of properties for the purpose of property tax (ad-valorem tax). The use of statistical methods in property tax collection is acceptable to many governments for two basic reasons: (1) the cost of valuing a portfolio of tens or hundreds of millions of properties each year would be unaffordable even for the most powerful governments; and (2) if someone will have to pay more or less property taxes as a result of applying these statistical methods compared to what they would be paid if each property were valued separately, for the government's coffers it would make little difference, as the pluses and minuses eliminate each other. Expropriations are not carried out every year and for every property. They are directly related to the obligation of citizens to move or be deprived of their property, against their will and as such can not be subject to the "humor" of statistical analysis.

Let me illustrate the above with a concrete example. Cadastral zones 8330 and 8350 in the city of Tirana are bordered by the Ring Road in the section from the former Train Station to Zogu i Zi (where the Harry Fultz School is located). The price of the land determined by DCM Nr. 89, dated Feb 3, 2016 pursuant to DCM Nr. 658, dated Sept. 26, 2012, is respectively 34,068 leks for cadastral zone 8330 and 66,969 leks for cadastral zone 8350. This means that a citizen living on the north side of the Ring Road, (zone 8330) is expropriated with almost half the value with which the neighbor across the street on the south side of the road is expropriated (zone 8350). If statistically it can be worth calculating the average price of land in zone 8330, which starts at Ring Road and ends at the River Bank as 34,068 leks, and it could be used for property tax purposes (if this type of tax would be calculated), it is absolutely unacceptable to use it as an indicator of market value to determine the just compensation during expropriation. Similar examples can be given from all cities of the country.

It's well known that the value of real estate is profoundly influenced by its location. This factor fails to be taken into account except from one cadastral area to another. So in cadastral zone 8330, the price of the land is the same at both the Ring and the River Bank. This is not the market price, as in the concept of market value there must be both a seller and a willing buyer to complete the transaction on a certain date. There is no landowner who would willingly agree to sell the property at the Ring at a price that is affected by the sale-purchase of the property on the River Bank. Real estate can be even more "capricious" than that. The price of a roadside shop is very different from the price of the same shop, 20 meters down an alley. This factor is excluded from statistical analysis but is essential for determining market value and consequently just compensation.

> *Bukuritë natyrore janë të padiskutueshme dhe nuk dua të hyj në komente për to, por shqetësim në tregun tonë krijon pastërtia dhe rregulli, që kanë shumë ndikim tek cilido turist që viziton Shqipërinë, detaje këto që vihen re dhe theksohen shpesh nga turistët.*

The methodology elaborated in Annex 1/1 of DCM Nr. 658, dated Sept. 26, 2012, stipulates unequivocally that the price of properties is calculated starting from the sales contracts registered in IPRO, which are statistically analyzed to eliminate deviations in order to reach a price as representative as possible of the analyzed property portfolio. But when it comes to land sale contracts many questions arise. Is there any Tirana resident that has sold empty land in the city center? To my knowledge, there are none. During the last 20 years, the land in Tirana, and not only, has been exchanged for building surfaces after land is used for construction, not sold empty. So on what information does the PRCA rely to determine the price of land in cities?

What are the reasons for the significant drop in the price of land in recent years? The crisis may be a factor. It is known that supply-demand affects the price of real estate. If the government blocks construction permits, or significantly increases the taxes of the construction sector, it negatively affects the value of land as it reduces the "appetite" of builders for it. Wouldn't this be called discriminatory in the context of expropriation? Would a fair value be a market value reduced either directly or indirectly by government actions or inactions, or because the government expropriates in times of crisis?

## CONCLUSION

Although there is no comprehensive definition of the term "just compensation" by most legislation in the world, it is understood that the amount of just compensation is, in most cases, greater than the market value, considering (1) eventual reduction of the value of the part of the property not expropriated, (2) the halt of development potential when the property is expropriated (3) other direct or indirect damages caused to the expropriated by the expropriation, etc.

First, it is necessary to fully review the procedure of determining the market value by state institutions for the purpose of determining just compensation in the context of expropriations.

Second, the best way would be that in any case of expropriation requested, IPRO issues sales contracts for an area of 100, 200 or 500 meters (depending on data availability) from the expropriated property and then a group experts, mainly appraisers, consider the specifics of each property being expropriated to reach their market value. If this data is missing for the location of the expropriated property other valuation methods should be used. This group should also address other factors that cause the expected value of any not-expropriated leftover part of the property to increase or decrease, or other damage caused to citizens by their relocation from one place to another.



timin fillimisht të vlerës së tregut dhe pastaj të shpërblimit të drejtë duke privuar pa dëshirën e tij pronarin e ligjshëm nga prona e tij?

Neni 4 shtjellon edhe llojet e pasurive që do t'i nënshtrohen kësaj metodologjie, vlera e tregut të të cilave përcaktohet nga kontratat e shit-blerjes. Nuk është aspak e qartë cilat do të jenë kontratat e shit-blerjes që do të përcaktonin vlerën e tregut të kopshteve, shkollave, çerdheve, stadiumeve, digave, hidrocentraleve, minierave, porteve, urave etj. Standardet ndërkombëtare të vlerësimit përcaktojnë se kur pronat janë shtetërore, jo për qëllime fitimi apo të cilat shiten shumë rrallë kryesisht si pjesë tërësore e bizneseve, vlerësohen bazuar në koston e amortizuar të zëvendësimit.

Aneksi 1/1 edhe pse nuk ka asgjë të përbashkët me standardet ndërkombëtare të vlerësimit, është një metodologji statistikore që njihet në profesionin e vlerësimit me termin "vlerësim masiv" (mass appraisal). Kjo procedurë përdoret në shumë vende për një qëllim të vetëm: vlerësimin e pronave për qëllimin e tatimit mbi pronë (ad-valorem tax). Përdorimi i metodave statistikore në mbledhjen e taksave mbi pronë është i pranueshëm për shumë qeveri për dy arsye themelore: (1) kostoja e vlerësimit çdo vit të një portofoli prej dhjetëra apo qindra milion pronash do të ishte i papërballueshëm edhe për qeveritë më të fuqishme dhe (2) nëse dikujt do t'i bjerë të paguajë më pak apo më shumë taksa mbi pronë si rezultat i zbatimit të këtyre metodave statistikore në krahasim me çfarë do të paguhej po të vlerësohej çdo pronë më vete, për "thesin" e qeverisë pak ndryshim ka, pasi plus minuset eliminojnë njëra-tjetrën.

Shpronësimet nuk kryhen çdo vit dhe për çdo pronë. Ato lidhen drejtpërdrejt me detyrimin e qytetarëve të zhvendosen apo privohen nga prona e tyre, pa dëshirën e tyre dhe si e tillë nuk mund të jenë subjekt i "humorit" të analizave statistikore.

Po e ilustroj sa më sipër me një shembull konkret. Zonat kadastrale 8330 dhe 8350 në qytetin e Tiranës kufizohen me njëra tjetrën me rrugën e Unazës në pjesën që fillon nga ish-stacioni i trenit deri tek Zogu i Zi (aty ku ndodhet shkolla Harri Fultz). Çmimi i truallit i përcaktuar me VKM nr. 89, datë 3.02.2016 në zbatim të vendimit Nr. 658, datë 26.9.2012, është përkatësisht 34.068 lekë për zonën kadastrale 8330 dhe 66.969 lekë për zonën kadastrale 8350. Kjo do të thotë se një qytetar që banon në anën veriore të Unazës, buzë rruge (zona 8330) shpronësohet me gati gjysmën e vlerës me të cilën shpronësohet komshiu i tij përballë në anën tjetër jugore të Unazës (zona 8350). Nëse statistikisht mund të ketë vlerë, që mesatarja e çmimeve të trojeve të zonës 8330, e cila fillon tek Unaza dhe mbaron tek Bregu i Lumit, të jetë 34.068 lekë, dhe mund të përdorej për tatimin në pronë (nëse kjo lloj takse do të llogaritej kështu), është absolutisht e papranueshme që të përdoret si tregues i vlerës së tregut për përcaktimin e shpërblimit të drejtë gjatë shpronësimit. Shembuj të ngjashëm mund të jepen nga të gjitha qytetet e vendit.

Dihet se vlera e pronave të paluajtshme ndikohet thellësisht nga vendndodhja e tyre. Ky faktor nuk arrin të merret parasysh përveçse nga një zonë kadastrale në tjetrën. Pra në zonën kadastrale 8330, çmimi i truallit është njësoj si tek Unaza ashtu edhe tek Bregu i Lumit. Ky nuk është çmimi i tregut, pasi në konceptin e vlerës së tregut duhet të ekzistojnë njëherësh një shitës dhe një blerës të vullnetshëm për ta realizuar transaksionin në një datë të caktuar. Nuk ka asnjë pronar trualli që do të pranonte me dëshirën e tij të lirë të shiste pronën në Unazë me çmimin që ndikohet nga shit-blerja e pronës në Bregun e Lumit. Pasuria e paluajtshme është edhe më "tekanjoze" se kaq. Çmimi i një dyqani në buzë rruge ndryshon shumë nga çmimi i një dyqani të njëjtë, 20 m më thellë në rrugicë. Ky faktor përjashtohet nga analiza statistikore, por është thelbësor për përcaktimin e vlerës së tregut dhe rrjedhimisht edhe të shpërblimit të drejtë.

> *Bukuritë natyrore janë të padiskutueshme dhe nuk dua të hyj në komente për to, por shqetësim në tregun tonë krijon pastërtia dhe rregulli, që kanë shumë ndikim tek cilido turist që viziton Shqipërinë, detaje këto që vihen re dhe theksohen shpesh nga turistët.*

Metodologjia e shtjelluar në Aneksin 1/1 të VKM Nr. 658, datë 26.9.2012, përcakton pa ekuivoke se çmimi i pronave llogaritet duke u nisur nga kontratat e shitjes të regjistruara në ZRPP të cilat analizohen statistikisht për të eliminuar devijimet në mënyrë që të arrihet në një çmim sa më përfaqësues të portofolit të analizuar të pronave. Por kur bëhet fjalë për kontratat e shit-blerjes së trojeve lindin shumë pyetje. Cili qytetar i Tiranës ka shitur truall bosh në qendër të qytetit? Në dijeninë time asnjë; gjatë 20 viteve të fundit trojet në Tiranë, dhe jo vetëm, janë këmbyer me sipërfaqe ndërtimi, por nuk janë shitur bosh. Atëherë mbi cilin informacion mbështetet AKKP për përcaktimin e çmimit të trojeve në mes të qyteteve?

Cilat janë arsyet e rënies së ndjeshme të çmimit të trojeve vitet e fundit? Kriza mund të jetë një faktor. Dihet që kërkesë-oferta ndikon mbi çmimin e pasurive të paluajtshme. Nëse qeveria bllokon lejet e ndërtimit, apo rrit ndjeshëm taksat e sektorit të ndërtimit, ajo ndikon negativisht në vlerën e trojeve pasi ul "oreksin" e ndërtuesve për to. A nuk do të quhej kjo diskriminuese në kuadër të shpronësimit? A do të ishte shpërblim i drejtë një vlerë tregu e ulur qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi nga veprimet apo mosveprimet e qeverisë, apo sepse qeveria shpronëson në kohë krize?

## PËRFUNDIM

Edhe pse nuk ka një përkufizim gjithëpërfshirës të termit "shpërblim i drejtë" nga shumica e legjislacioneve në botë kuptohet se masa e shpërblimit të drejtë është, në shumicën e rasteve, më e madhe sesa vlera e tregut, për të marrë parasysh (1) uljen eventuale të vlerës së pronës së mbetur e pa shpronësuar, (2) potencialin e zhvillimit të pronës që shpronësimi ndërpret apo (3) dëme të tjera të drejtpërdrejta ose të tërthorta që i shkaktohen të shpronësuarit nga shpronësimi, etj.

Së pari, është domosdoshmëri rishikimi i plotë i procedurës së caktimit të vlerës së tregut nga ana e institucioneve shtetërore për qëllimin e përcaktimit të shpërblimit të drejtë në kuadër të shpronësimeve.

Së dyti, rruga më e mirë do të ishte që në çdo rast kërkese për shpronësim, ZRPP të nxirrte kontratat e shitjes për një zonë prej 100m, 200m apo 500m (në varësi të disponibilitetit të të dhënave) nga prona që shpronësohet dhe pastaj një grup ekspertësh, kryesisht vlerësues, të merrnin parasysh veçoritë e secilës pronë që shpronësohet për të arritur në vlerën e tyre të tregut. Nëse këto të dhëna mungojnë për vendndodhjen e pronës që shpronësohet duhen përdorur metodat e tjera të vlerësimit. Gjithashtu ky grup duhet të trajtojë faktorët e tjerë që bëjnë që vlera e pritshme e pjesës së mbetur e pashpronësuar rritet ose zvogëlohet, apo dëme të tjera që i shkaktohen qytetarëve nga zhvendosja e tyre nga një vend në tjetrin.


smile.al
DHURO
PËR NJË BUZËQESHJE!
FUQIZIMI I SHOQËRISË
DHE INOVACIONIT
E-mail: info@smile.al